



tirana
EUROPEAN
YOUTH
CAPITAL '22



**BASHKIA
TIRANË**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
KRYETARI**

VENDIM
Nr. 5757, datë 28.2.2022

“PËR

MIRATIMIN E PLANIT VJETOR TË BASHKISË TIRANË PËR VITIN 2022”

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenin 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 64, shkronja “a” të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, vendimit nr. 48492, datë 20.12.2019 të Kryetarit të Bashkisë “Për miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës së aparatit të Bashkisë Tiranë”, vendimit nr 160, datë 21.12.2018 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të Qendrueshëm të Bashkisë Tiranë 2018 – 2022”, si dhe në vijim të Memos me nr. 5757 prot., datë 08.02.2022, të Drejtorisë së Përgjithshme të Integritit, Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit Ekonomik, me lëndë “Miratimin e Planit Vjetor të Bashkisë Tiranë për vitin 2022”,


VENDOSA:

1. Miratimin e planit vjetor të Bashkisë Tiranë për vitin 2022, sipas materialit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Ngarkohen të gjitha drejtoritë e përgjithshme të aparatit të Bashkisë Tiranë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Erion VELIAJ





PLANI VJETOR BASHKIA TIRANË Viti 2022

DREJTORIA E INTEGRIMIT, PLANIFIKIMIT STRATEGJIK DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK

SHKURT 2022

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Misioni i Bashkisë Tiranë (BT) është garantimi i një qeverisjeje të drejtë dhe efikase me qytetarët, duke njohur dhe respektuar ekzistencën e identiteteve dhe vlerave të ndryshme të komunitetit, respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të tyre, duke përkrahur dhe siguruar mirëqenie e duke promovuar standarde bashkëkohore në ofrimin e shërbimeve, mjedis të shëndetshëm, vlera të larta të bashkëjetesës komunitare dhe një ndjenjë të pronësisë/zotërimit mes banorëve mbi të mirat publike.

Për të përmbushur këtë mision Bashkia e Tiranës, Drejtoria e Përgjithshme e Integritit, Planifikimit Strategjik, Zhvillimit Ekonomik ka hartuar Planin vjetor të Bashkisë Tiranë për vitin 2022 (PVBT). Ky dokument shpalos objektivat dhe prioritetet e institucionit në mënyrë të hollësishme ku për çdo Drejtori të Përgjithshme janë përcaktuar objektivat dhe projektet/aktivitetet që do të zhvillohen nga kjo strukturë. Mbështetur tek detyrat dhe misionet që ka çdo drejtori, janë përcaktuar indikatorët që do të shërbejnë për matjen e realizmit të këtij plani.

PVBT 2022 përcakton në mënyrë të hollësishme të gjithë veprimet që duhen ndërmarrë për të arritur objektivat dhe prioritetet strategjike. Ky dokument është hartuar sipas:

- (i) Funksioneve, kompetencave dhe detyrave të përcaktuara nga kuadri ligjor dhe rregullorja e BT-së;
- (ii) Prioriteteve dhe objektiveve të përcaktuara nga Strategjia e Zhvillimit të Qendrueshëm të Bashkisë Tiranë 2018 – 2022 dhe
- (iii) Planeve vjetore të strukturave organizative të BT-së.

Në këtë dokument janë përcaktuar prioritetet e aparatit të BT për vitin 2022, detajuar në objektiva, projekte/aktivitete dhe indikatorë të monitorueshëm për të gjitha drejtoritë përkatëse. Për shkak të gjendjes dhe pasojave të Pandemisë Covid-19, ka psur mjaft projekte të cilat nuk janë realizuar plotësisht gjatë vitit 2021, prandaj vijojnë të mbeten në fuqi edhe gjatë vitit 2022.

Hartimi dhe ekzekutimi i këtij plani do të japë një kontribut jo vetëm në përmbushjen e prioriteteve dhe synimeve që ka Bashkia e Tiranës për vitin 2022, por gjithashtu do të lehtësojë bashkëpunimin mes strukturave, e do të përmirësojë procesin e transparencës me qytetarët, këta të fundit përfitues të drejtpërdrejtë nga përmbushja e këtyre objektiveve.

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE TË BASHKISË TIRANË PËR VITIN 2021

I. Përmirësimi i infrastrukturës arsimore dhe rritja e aksesit dhe gjithpërfshirjes në arsim

Vizioni i BT-së në drejtim të sektorit të arsimit synon ofrimin e një infrastrukture moderne të institucioneve arsimore, që bazohet në plotësimin e nevojave dhe interesave të nxënësve dhe studentëve në Tiranë, për të garantuar rritjen e cilësisë së mësimdhënies, sigurimine standardeve dhe aksesit më të lartë nga të gjithë grupet shoqërore në të gjithë territorin, standarde në rezidencat universitare si dhe kthimin e institucioneve arsimore në qendra të rëndësishme komunitare.

Përmirësimi i cilësisë së infrastrukturës arsimore si dhe krijimi i infrastrukturave të reja do të vazhdojë të jetë një objektiv strategjik edhe për vitin 2021. Gjithashtu BT i ka dhënë prioritet më shumë se kurrë rritjes së aksesueshmërisë arsimore për grupet e pa favorizuara si fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët në zona të thella rurale dhe ata me ndihmë ekonomike duke iu përmbajtur vizionit të saj dhe atij kombëtar.

Rezidencat universitare do të vazhdojnë të jenë në fokus të punës së BT edhe për këtë vit duke qenë se Tirana akomodon numrin më të lartë të studentëve në të gjithë Shqipërinë, kjo jo vetëm për faktin se në kryeqytete janë përqendruar numri më i madh i institucioneve të arsimit të lartë por sepse metropoli ofron më shumë mundësi për punësim.

BT synon të nxisë shfrytëzimin maksimal të hapësirave të këtyre objekteve në funksion të edukimit dhe ndërveprimit të komunitetit nëpërmjet programit “Shkolla si Qendra Komunitare”.

II. Qytet i aksesueshëm dhe gjithpërfshirës

PSBT për vitin 2021 e vë theksin në zhvillimin e një qyteti gjithpërfshirës, i cili është në funksion të qytetarëve dhe garanton një zhvillim të integruar ekonomik, social dhe territorial duke rritur mirëqënien e qytetit.

Tirana për të gjithë përbëhet nga një grup politikash me fokus rritjen e cilësisë së jetës së qytetarëve dhe rritjen e aksesueshmërisë së qytetit nga të gjithë. Nëpërmjet këtij objekti, synohet përmirësimi i një sërë elementesh me impakt të drejtpërdrejtë tek çdo grupmoshë e popullsisë që përfshihen në territorin e BT-së.

Ky objektiv është një ndër më sfidueset dhe synon të nxisë mobilitetin alternativ nëpërmjet zgjerimit të rrjetit të korsive të dedikuara për biçikleta dhe përmirësimit të shërbimit të operatorëve në këtë fushë, të përmirësojë situatën e parkimit nëpërmjet rritjes së kapacitetit dhe përdorimin efiçent të hapësirave ekzistuese dhe përmirësimit të shërbimit të parkimit me pagesë. Vëmendje ka edhe transporti publik ku do të garantohet një sistem transporti i sigurt, miqësor ndaj mjedisit dhe me eficiencë të lartë për distanca mbi 5 km.

Hapësirat publike të gjelbra do vazhdojnë të jenë nën një proces transformimi të qendrueshëm me qëllim shtimin e sipërfaqeve që i japin frymëmarrje qytetit. Vëmendje edhe për këtë vit do të kenë rehabilitimet e blloqeve të banimit si dhe nxitja e bashkëpunimit efektiv mes BT-së dhe qytetarëve për përmirësimin e infrastrukturës së objekteve në bashkëpronësi.

Përpjekjet e BT-së për të siguruar një qytet të pastër, me një sistem të mirë të manaxhimit të mbetjeve dhe të furnizimit e ujë do të vazhdojnë dhe zbatimi i projekteve të planifikuara do të japë efektet e pritshme për të gjithë qytetarët.

III. Rivitalizim urban që harmonizon infrastrukturën, shërbimet publike dhe nxit zhvillimin ekonomik

Me reformën administrative territoriale BT tashmë përfshin një territor me një sipërfaqe rreth 25 herë më të madh dhe heterogjen. Kjo ka nxitur projektimin e një sistemi policentrik që bazohet jo vetëm në praninë e disa epiqendrave urbane, me orientim ekonomik dhe shoqëror por edhe me ndërveprim dhe ndërvarësi që lindin prej tyre.

Dinamikat policentrike të ardhshme janë përcaktuar duke marrë në konsideratë praninë e sektorëve të rëndësishëm të ekonomisë, karakteristikat e veçanta shoqërore dhe sociale dhe profilet aktuale të zhvillimit. Krahas funksioneve kryesore për çdo pol është parashikuar përmirësimi i shërbimeve bazike shkolla, çerdhe, kopshte, infrastrukturë rrugore, parqe, qendra komunitare dhe kulturore, etj. Për secilin pol është parashikuar një kuotë ndërtimi në konvencion apo subvencion me shërbimet kryesore në mënyrë që të kthehen në zona të pëlqyeshme në çdo orë të ditës. Projektet që parashikohen të zbatohen për krijimin dhe funksionimin e pesë poleve urbane, gjatë vitit 2021 do të realizohen në tre shkallë:

Policentrizëm në shkallë urban. Në këtë fazë në vëmendje do të jenë rehabilitimi dhe mobilimi urban që përfshin infrastrukturën e rrjeteve inxhinjrike, rrjetit rrugor, hapësirave publike, sipërfaqeve të gjelbra, ndriçim etj

Policentrizëm në shkallë lokale. Fokusi në këtë fazë do të jetë mbi furnizimin me shërbime publike i epiqendrave dhe zonave përreth. Këtu përfshihen ndërtim/rehabilitim i shkollave, çerdheve dhe kopshteve, tregjeve publike, qendrave sociale, kënde lojrash, terrene sportive etj.

Policentrizëm në shkallë territoriale. Në këtë fazë do themelohen institucione/partneritet me komunitetin apo aktorë të tjerë të përfshirë që do të krijojnë tipare të dallueshme sipas karakterit të çdo poli.

IV. Garantimi i zhvillimit të qendrueshëm ekonomik

Ekonomia e Tiranës në përgjithësi ka qenë dhe vazhdon të jetë e ushqyer nga sektorët e shërbimeve, tregtisë, ndërtimit dhe transportit. Si sektorët me prurjet më të mëdha të të ardhurave gëzojnë vëmendjen më të madhe dhe të vazhdueshme si nga pushteti vendor edhe nga ai qendror. Por tashmë, sipërfaqja e shumëfishuar e BT-së me 13 NJA-të rurale dhe kompetencat e reja që i kanë kaluar BT-së, evidentojnë nevojën për ti kushtuar vëmendje më të lartë zhvillimit të qendrueshëm të ekonomisë.

Qëllimi është të krijohen modele të qëndrueshme në tre aspektet/kolonat e veprimtarisë njerëzore: ekonomike, sociale dhe ekologjike. Zhvillimit i qëndrueshëm i ekonomisë nënkupton gjetjen e një ekuilibri koherent dhe një harmonie afatgjatë në mes të këtyre tre kolonave. Kjo çështje ndërsektoriale do të jetë sfida edhe për vitin 2021 për BT, që duhet të marrë në konsideratë këto aspekte në përcaktimin dhe zbatimin e politikave dhe duhet të përfshijë domosdoshmërisht pjesëmarrjen e vazhdueshme të të gjitha palëve të interesuara (qytetarët, bizneset, shoqatat, etj) si formë e suksesshme e demokracisë pjesëmarrëse.

Duke qenë se zhvillimi i ekonomisë është një proces transformimi në të cilin shfrytëzimi i burimeve natyrore, përzgjedhja e investimeve, orientimi i ndryshimeve teknologjike dhe institucionale realizohen duke garantuar qëndrueshmëri në të ardhmen, janë parashikuar programe e projete që synojnë përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe pajisja me infrastrukturën e nevojshme për bizneset, mbështetje financiare dhe incentive fiskale, ritja e konkurrueshmërisë dhe thithja e investimeve të huaja.

V. Forcimi i qeverisjes së mirë dhe respektimi i të drejtave të qytetarëve

Qeverisja e mirë përbën ndër kushtet thelbësore që duhet të plotësojë një shtet demokratik dhe sidomos aspirues për tu integruar në BE. Qeverisja e mirë fillon në nivel vendor dhe të njëjtat parime të qeverisjes së mirë, aplikohen edhe në nivel qendror. Këto parime janë shprehur qartë në Kartën Europiane të vetëqeverisjes vendore, të cilën Shqipëria është angazhuar ta zbatojë. Bazuar edhe tek parimi i subsidiariteti, përgjegjësitë publike duhet të ushtrohen nga autoritetet të cilat janë më pranë qytetarëve. Autoritetet e QV-ve janë në pozicionin më të mirë dhe më të informuar për të ndërmarrë veprime të suksesshme në nivel vendor dhe rajonal. Kjo nënkupton jo vetëm pushtet vendor por edhe përgjegjësi vendore. BT ka përcaktuar si prioritet të saj forcimin e qeverisjes së mirë dhe respektimin e të drejtave të qytetarëve i cili do të realizohet nëpërmjet 3 programeve:

Rritja dhe forcimi i kapaciteteve institucionale dhe burimeve njerëzore në nivel vendor ka për qëllim funksionimin me eficiencë të lartë të sistemit të zhvillimit të kapaciteteve dhe burimeve njerëzore të administratës së BT-së në koordinim me planet dhe objektivat strategjike të institucionit me synimin e vetëm, përmirësimin e ofrimit të shërbimeve publike.

Sigurimi i një qeverisjeje transparente dhe rritja e llogaridhënies ka për qëllim garantimin e njëqeverisje të mirë të orientuar drejt qytetarëve. Vendimarrja vendore do të jetë gjithpëfshirëse dhe transparente dhe me pjesëmarrje të balancuar gjinore. Llogaridhënia në nivel vendor do të nxitet edhe nëpërmjet zbatimit të sistemeve të menaxhimit të performancës, që do të jenë instrumente objektive në transparencën dhe llogaridhënien e njësive të qeverisjes vendore.

Forcimi i financave vendore që ka për qëllim garantimin e një menaxhimi financiar të shëndoshë në BT. Praktikrat më të mira të menaxhimit financiar në nivelin do të shoqërohen me rritjen e llogaridhënies dhe kontrollin financiar për të shmangur abuzimet dhe korrupsionin në nivel vendor.

Për këtë objektiv në bashkëpunim me të gjitha strukturat e BT-së janë përcaktuar 3 programet dhe 7 aktivitetet/projektet të cilat do të bëjnë të mundur përmbushjen e këtij objektivi. Në këtë plan janë përcaktuar gjithashtu edhe indikatorët të cilët do të përdoren për procesin e monitorimit dhe vlerësimit të përmbushjes së objektivit.

STRUKTURA E BT-SË DHE PLANET E DREJTORIVE TË PËRGJITHSHME

Bashkia e Tiranës është e organizuar në 12 drejtori të përgjithshme në varësi të plotë nga Kryetari dhe nga 57 drejtori, kjo mbështetur në Urdhrin e Kryetarit nr. prot. 52115, datë 31.12.2021 Për “Miratimin e Strukturës dhe Organikës të Institucionit të Bashkisë së Tiranës.”.

Mbështetur në Rregulloren për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Tiranë, është krijuar një kuadër rregullator për funksionimin me efikasitet të administratës, ku secila prej këtyre strukturave ka një mision të caktuar me detyra përkatëse.

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj administrata e BT-së bazohet në këto parime:

Parimi i Unitetit dhe Hierarkisë Ky parim njeh detyrimin e çdo strukture për të respektuar varësinë dhe llogaridhënien ndaj çdo organi, institucioni, apo njësie administrative. Respektimi i hierarkisë brenda strukturës së BT është themeltar për parimet e tjera që ushtrojnë ndikim brenda institucionit, por dhe në raport me qytetarët.

Parimi i Llogaridhënies dhe Transparencës Çdo element i aparatit të BT është nën udhëheqjen dhe mbikqyrjen e eprorëve respektivë. Nëpërmjet këtij parimi, synohet zhvillimi i kompetencave të çdo elementi në BT përkundrejt vendimeve apo veprimeve sa më transparente ndaj publikut si dhe brenda institucionit.

Parimi i Dekoncentrimit Nëpërmjet këtij parimi, synohet bashkëpunimi sa më i ngushtë me qytetarët, për t'u ofruar atyre transparencë, efikasitet në marrje shërbimesh apo të dhënash. Kjo do të arrihet nëpërmjet përmbushjes me sukses të funksioneve administrative.

Parimi i Qartësisë Ky parim shpreh se përgjegjësitë dhe detyrat që mban çdo element i strukturës së BT duhet të jenë sa më të qarta dhe të shpërndara në mënyrën e duhur. Kjo do të sjellë lehtësi në kryerjen e detyrave që ka çdo njësi në aparatit të BT, si dhe një bashkëveprim më efikas jo vetëm me stafin, por dhe qytetarët.

Parimi i Ekonomisë, Efijencës dhe Efektivitetit Ky parim ka për synim një organizim sa më fleksibël të administratës në BT, gjë që sjell rezultate të qarta dhe të suksesshme në funksionet përkatëse të saj. Gjithashtu ky parim luan një rol shumë të rëndësishëm në politikat e BT dhe shfrytëzimin me shumë rezultat të komoditeteve dhe fondeve të caktuara.

Parimi i Bashkëpunimit Bashkëpunimi i ngushtë dhe i suksesshëm i strukturave të pushtetit vendor, por edhe me organet apo institucionet e pavarura, është synimi i këtij parimi. Kjo do të sjellë një përmbushje me sukses të detyrave që janë jo vetëm detyrë e kësaj strukture, por dhe detyrim ligjor.

Parimi i Ndalimit të Konfliktit të Interesave Ky parim mbështetet në Ligjin 44/2015 “Kodi të Procedurave Administrative” dhe Ligjin nr.9367, datë 07.04.2005 për “Parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” (të ndryshuar). Rrjedhimisht, ky parim i mohon stafit të BT pjesëmarrjen në procese vendimmarrëse, nëse ka shkelje të caktuara të këtyre Ligjeve.

Parimi i Mbrojtjes së Interesit Publik Ky parim nxit strukturën dhe stafin e BT që të ushtrjnë detyrën apo funksionet e tyre rregullisht dhe vetëm në interes dhe shërbim të publikut. Respektimi i këtij parimi sjell jo vetëm rezultate të kënaqshme, por zhvillon edhe raportin institucion-qytetar, duke u rritur këtyre të fundit kështu besimin ndaj BT.

Parimi i Ndershmërisë dhe Paanshmërisë Nëpërmjet këtij parimi, synohet një bashkëpunim sa më neutral dhe i ekuilibruar midis funksionarëve të BT dhe qytetarëve që kërkojnë të dhëna apo shërbime. Rrjedhimisht, paanshmëria dhe ndershmëria e këtyre funksionarëve është në përputhje të plotë me kodin e etikës së administratës publike.

📁 Kryetari i Bashkisë

📄 Drejtoria e Zonës së Lirë Ekonomike, Investimeve të Huaja dhe Diasporës

📄 Nënkryetarët

📄 Këshilli Bashkiak

📄 Kabineti

📄 Drejtoria e Auditit Të Brendshëm

📁 Drejtoria e Përgjithshme e Teknologjisë së Informacionit Inovacionit dhe të Dhënave

📁 Drejtoria e Përgjithshme e Medias dhe Komunikimit

📁 Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të NjA dhe Emergjencave Civile

📁 Drejtoria e Përgjithshme e Integritimit, Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit Ekonomik

📁 Drejtoria e Përgjithshme e Promovimit të Qytetit

📁 Drejtoria E Përgjithshme E Planifikimit Dhe Zhvillimit Të Territorit

📁 Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike

📁 Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale

📁 Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar

📁 Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licensimit

📁 Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore

📁 Drejtoria e Përgjithshme për Marrëdhënien me Publikun dhe Jashtë

📁 24 Njësitë Administrative dhe 3 Lagje

MONITORIMI I PLANIT VJETOR TË BASHKISË TIRANË

Sistemi i monitorimit dhe vlerësimit kërkon përpjekje të përkushtuara, ekspertizë, aftësi, vlerësim dhe manaxhim të mirë. Ky proces konsiderohet si një nga më të rëndësishmit gjatë periudhës së zbatimit të PVBT për vitin 2022, pasi shmang devijimet nga përmbushja e objektivave të. Me qëllim që të sigurohet monitorim dhe raportim cilësor dhe i dobishëm, është e nevojshme që të përcaktohet sa më poshtë vijon:

Procesi i qartë i raportimit dhe i monitorimit. Ky proces është mirëorganizuar brenda institucionit, pasi secila nga strukturat përvec planeve vjetore përgatit planet dhe raportimet mujore, ky cdo njësi përshkruan detyrat që do të realizojë si dhe detaje teknike ku shpjegohen edhe vonesat nëse ka të tilla.

Modelet dhe instrumentet që do të përdoren për monitorimi, formatët e raportimit janë të unifikuar dhe strukturua në mënyrë të tillë që informacioni të jetë lehtësisht i kuptueshëm edhe i qartë si për ata që planifikojnë dhe raportojnë ashtu edhe për strukturat monitoruese.

Kapaciteti i strukturave kryesore dhe pjesëmarrëse. Të gjitha strukturat e BT-së janë njohur me procesin e planifikimit dhe të raportimi si dhe janë trajnuar mbi hedhjen e informacionet në fornatet përkatëse.

Struktura që do monitorjë realizimin e objektivave të PVBT me mbylljen e vitit 2021, është Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Jetësimit të Prioriteteve, e cila do të përgatisë një matrice me të gjithë indikatorët e raportuar nga strukturat mbi realizimin e Planit, ku do të përshkruhen objektivat e përmbushur dhe në rast se ka objektiva apo projekte të pa-zbatuar do të jepen shpjegime për shkaqet e mosrealizimit.

PLANI I DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BURIMEVE NJERËZORE 2022

Misioni:	DPBNJ është përgjegjëse për mirëadministrimin e burimeve njerëzore të institucionit, nëpërmjet planifikimit sa më adekuat të tyre, rekrutimit konform ligjit, përmirësimin dhe fuqizimin e kapaciteteve profesionale të burimeve njerëzore, për krijimin, ruajtjen, shfrytëzimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë dokumentare dhe mbarëvajtjen e komunikimit dokumentar brenda Bashkisë			
OBJEKTIVAT	PROJEKTE / AKTIVITETE		DREJTORIA PËRGJEGJËSE	
Përmirësimi i infrastrukturës nëpërmjet një sistemi të digjitalizuar dhe rritjen e aftësisë profesionale	1.1	Digjitalizimi i Arkiv Protokollit në bashkëpunim me Drejtorinë e IT	Drejtoria e Arkivit Qendror dhe Protokollit	
	1.2	Trajnime për arkivistet e drejtorise dhe NJ.A në bashkëpunim me Arkivën e Shtetit		
Rritja e kapaciteteve dhe aftësisë profesionale të stafit të BT	2.1	Ofrimi i trajnimeve cilësore dhe me kosto efektive të cilat synojnë rritjen e produktivitetit dhe një performancë të lartë të stafit dhe organizatës.	Drejtoria e Procedurave të Burimeve Njerëzore dhe Trajnim Zhvillimit	
Terheqja e talentëve përmes praktikave, programeve, projekteve dhe panairëve të punës	3.1	Realizimi i projektit "Fillo me një ide - Fito një Internship në Bashkinë Tiranë";		Numri i fituesve
		Miratimi dhe zbatimi i projektit të ri të internshipit "Apps Challenge-Tirana"		Numri i fituesve
		Marrëveshje bashkëpunimi me Institucionet e Arsimit të Lartë, Publik dhe Privat		Numri i marrëveshjeve
		Programi Kombëtar i Praktikave të Punës		Numri i fituesve
		Ndjekja dhe realizimi i procesit të praktikave në BT		Numri i praktikantëve
		Ndjekja dhe realizimi i panairëve të punës		Numri i panairëve
Ndjekja dhe realizimi i procesit të konfirmimit të statusit të Nëpunësit Civil	4.1	Ndjekja e trajnimit të detyrueshëm pranë ASPA, brenda afatit 1 vjeçar të periudhës së provës, nga të gjithë nëpunësit civil të cilët emërohen për herë të parë në kategorinë ekzekutive.	Numri i nc në periudhë prove të trajnuar	
		Nxjerrja e Aktit të Deklarimit të Statusit të Nëpunësit, për çdo nëpunës të konfirmuar.	Numri i akteve të deklarimit të statusit të nc	

Ndjekja dhe zbatimi i strukturës së miratuar të Bashkisë Tiranë	5.1	Administron dhe garanton mbarëvajtjen e procesit të rekrutimit të burimeve njerëzore, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë . Harton draft plane pune dhe veprimi në lidhje me pranimin në shërbimin civil, evidentimin e vendeve vakante në organikë, kontratat e punës, ndjekjen dhe plotësimin e tyre me personel.	Drejtoria e Procedurave të Burimeve Njerëzore dhe Trajnim Zhvillimit	Numri i akteve
Ndjekja dhe zbatimi i strukturës së miratuar të Bashkisë Tiranë	5.2	Kordinon punën në bashkëpunim me Komisionin Përzgjedhës, për procesin e rekrutimit në Policinë e Bashkisë së Tiranës.		Numri i akteve
	5.3	Permiresimi dhe krijimi (bashkimi/ristrukturimi) i disa institucioneve te BT;		Numri i akteve
Monitorimi i masave që rrjedhin nga ligjet në fuqi për mirëadministrimin e informacionit dhe dokumentacionit perkates	6.1	Organizon punën për administrimin teknik të dosjeve të personelit të Aparatit, 24 Njësive Administrative +3 Lagjeve, Policisë së Bashkisë Tiranë, TaskëForca, Drejtorisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, sipas elementëve të përcaktuara nëperputhje me legjislacionin ne fuqi		Numri i akteve
Standartizimi i procesit të vlerësimit të performancës për Nëpunësin Civil & për punonjësit e institucionit me Kontratë Individuale Pune	7.1	Administrimi i procesit të vlerësimit të rezultateve individuale në punë për NC të institucionit	Drejtoria e Vlerësimit të Performancës Masave Administrative, Motivimit të Stafit	% e NC te vleresuar per cdo periudhe vleresimi; Nr. trajnimeve te ofruara dhe nr. pjesemarresve
	7.2	Administrimi i procesit të vlerësimit vjetor të performancës për stafin e punonjësve me Kontratë Individuale pune në institucion, si dhe për ato struktura të varësisë stafi i të cilave administrohen nga DPBNJ		Numri I punonjesve civile te vleresuar Numri I punonjesve me kontrate te vleresuar

Standartizimi i procesit të vlerësimit të performancës për Nëpunësin Civil & për punonjësit e institucionit me Kontratë Individuale Pune	7.3	Trajnime të dedikuara, në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të standartizimit të vlerësimit të performancës	Drejtoria e Vlerësimit të Performancës Masave Administrative, Motivimit të Stafit	Nr I trajnimeve të ofruara Nr. I personave qe kane perfutuar trajnim
	7.4	Pilotimi i vlerësimit 360 gradë për një strukturë/njësi organizative të institucionit.		Nr. NC te anketuar Raporti perfundimtar
Standartizimi i procedurës të hetimit administrativ për shkeljejt disiplinore	8.1	Administrimi dhe trajtimi i çdo kërkesë për fillim ecurie disiplinore ndaj NC apo punonjësve me kontratë të BT-së, konform kriterëve që parashikon legjislacioni respektiv.		Nr. Kerkesave; Nr. Masave disiplinore per NC dhe per punonjesit me Kontrate
	8.2	Miratimi i Procedurave Standarte të Veprimit për 'Procedimin disiplinor ndaj NC për shkelje të lehta', 'Procedimin disiplinor ndaj NC për shkelje të rënda dhe shumë të rënda' dhe 'Procedimin disiplinor ndaj punonjësve me kontratë pune'.		Numri i PSV-ve te miratuara.
	8.3	Trajnime të dedikuara për këtë komponent, në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të kompetencës në trajtimin e praktikave të shkeljeve disiplinore.		Nr. Trajnimeve te ofruara Nr. Personave te trajnuar
	8.4	Ngritje kapacitetesh per strukturat me punonjes me Kontrate pune nepermjet:		Nr. Trajnimeve te ofruara Nr. Personave te trajnuar
	8.5	Analizë sasiore dhe cilësore e këtij komponenti në baza vjetore		Realizimi I analizes %
Fuqizimi i rolit Strategjik të BNJ si një partner kyc tek të gjitha DP, NJA-të e BT për të menaxhuar kapitalin njerëzor në mënyrë sa më të efektshme dhe për të rritur efektivitetin e BT.	9.1	Matja konstante e nivelit të kënaqësisë së qytetarëve për shërbimin e ofruar nga stafi i BT, nëpërmjet intervistave mujore sipas metodes 'face to face' në sportelet e pritjes së qytetarit në BT.		Nr. Intervistave te realizuara Nr. Relacioneve te pergatitura
	9.2	Procesi i pajisjes me formularë të përshkrimeve të punës si e parashikon legjislacioni për NC të institucionit.		Numri i pershkrimeve te punes të rishikuara Numri I FPP te realizuar në total për NC e institucionit, 2022.
	9.3	Përditësimi i Rregullores së Institucionit në përputhje me ristrukturimet/ndryshimet e kërkuara.		Regullore e permiresuar

Fuqizimi i rolit Strategjik të BNJ si një partner kyc tek të gjitha DP, NJA-të e BT për të menaxhuar kapitalin njerëzor në mënyrë sa më të efektshme dhe për të rritur efektivitetin e BT.	9.4	Hartimi I Kodit të Etikës për Institucionin/ Publikimi I saj në faqen zyrtare të BT-së.	Drejtoria e Vlerësimit të Performancës Masave Administrative, Motivimit të Stafit	Kod etike I miratuar
	9.5	Hartimi/Përditësimi/Finalizimi i procedurave standarte të veprimit (PSV) të institucionit.		Numri I PSV-ve te miratuara; Numri I PSV-ve të rishikuara e dërguara në SALL/DPJAL për opinion ligjor.
	9.6	Takime periodike për përditësimin e procedurave të shërbimit të BT-së nëse do të ketë shërbime shtesë të identifikuar nga D.Komunikimit me qytetaret. Në bashkëpunim me Projektin e STAR 4 do të vijojnë organizimet me drejtoritë përkatëse dhe raportimet në lidhje me problematikat e shfaqura gjatë aplikimit të sistemit.		Numri i shërbimeve që operojnë në sistem; Numri I shërbimeve të identifikuar në proces.
Përmirësimi i nivelit të motivimit dhe angazhimit të punonjësve nëpërmjet implementimit të shpërblimeve të lidhura me performancën dhe instrumentave të tjerë jo-financiarë	10.1	Monitorimi i nivelit të kënaqësisë në punë dhe të motivimit për punonjësit e Bashkisë nëpërmjet kryerjes së një sondazhi një herë ne vit, për këtë qëllim.		Numri I te anketuare
	10.2	Implementimi i shpërblimeve të lidhura me performancën në fund të vitit duke përdorur Fondin e Vecantë për vitin 2022.		Numri I personave te trajtuar me shperblim
	10.3	Furnizimi I te gjithe stafit te aparatit te BT me uje të pijshëm, si një detyrim ligjor i punëdhënësit referuar Kodit të Punës ne bashkepunim me DPMF, DPPP-Dr. Sherbimeve Mbeshtetese dhe Dr. Prokurimeve.		Sasia e ujit te prokuruar per stafin e aparatit te BT.
	10.4	Organizimi i aktivitetit me rastin e festës së 8 Marsit.	Organizimi I aktivitetit me sukses	
	10.5	Organizimi i eventit për stafin me rastin e fundit të vitit.	Organizimi I aktivitetit me sukses	

PLANI I DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË MENAXHIMIT FINANCIAR 2022

Misioni:	DPMF është përgjegjëse për menaxhimin e të gjitha fazave të procesit buxhetor të Aparatit të Bashkisë së Tiranës, për menaxhimin dhe sigurimin e vlerave financiare dhe materiale, për administrimin e çdo çështje që lidhet me zhvillimin e praktikave të financimeve dhe mbështetjes donatore, për monitorimin e treguesve ekonomikë dhe financiarë të ndërmarjeve me vetëfinancim dhe SHA-ve		
OBJEKTIVAT	PROJEKTE / AKTIVITETE		DREJTORIA PËRGJEGJËSE
Hartimi i Planit Buxhetor vjetor dhe Afatmesëm të institucionit mbështetur në prioritetet dhe objektivat e Bashkisë së Tiranës.	1.1	Hartimi i Planit Financiar Buxhetor Afatmesëm e Vjetor . Hartimin e Urdhërit të Kryetarit për ngritjen e Grupit për Menaxhim Strategjik, si dhe kalendarit të përgatitjes së PBA-së. Pergatitja e tavaneve si dhe e fazave te planifikimit buxhetor afatmesem	Drejtoria e Buxhetit
Ndjekja dhe zbatimi i buxhetit të Bashkisë së Tiranës duke garantuar ligjshmërinë dhe eficientë në përdorimin e burimeve financiare.	2.1	Hartimi i Urdhrave te kryetarit apo Projekt Vendimeve per celjet e fondeve, ndryshimet e buxhetit, rishperndarjet e fondeve	
Monitorimi i procesit të Programimit Buxhetor Vjetor duke analizuar performancën e treguesve buxhetorë në arritjen e rezultateve dhe kryerjen e aktiviteteve të planifikuara.	3.1	Monitorimi, hartimi dhe raportimi i informacioneve periodike dhe vjetore te njesive shpenzuese te Bashkise Tirane Raportimi i realizimit te treguesve te performances sipas programeve buxhetore	
Menaxhimi dhe përdorimi i fondeve që transferohen nga programi i veçantë i buxheti të shtetit për Bashkinë Tiranë, në funksion të realizimit të programeve të procesit të rindërtimit	4.1	Planifikimin e përdorimit të fondeve që transferohen nga programi i veçantë i buxheti të shtetit për Bashkinë Tiranë	
	4.2	Vlerësimin e kërkesave te subjekteve që përfitojnë nga programet e procesit të rindërtimit, në bazë të dokumentacionit përkatës dhe parashikimeve	
			Plan I hartuar Urdher I hartuar Tavane te miratuara
			Realizimi me sukses
			Numri I raporteve Raport I treguesve te performances I hartuar
			Realizimi ne %
			Numri I subjekteve perfituese nga programi I procesit te rindertimit

Monitorimi i treguesve ekonomikë dhe financiarë për mbrojtjen e interesave të Bashkisë së Tiranës në marrëdhënie me ndërmarrjet me vetëfinancim dhe SHA-të	5.1	Monitorimi dhe vlerësimi i performancës së treguesve financiarë, të ardhura shpenzimeve, debitoreve dhe kreditoreve, të SHA-ve dhe ndërmarrjeve me vetëfinancim.	Drejtoria e Monitorimit Financiar të Ndërmarrjeve dhe SHA-ve	% e Ndermarrjeve dhe SHA-ve të cilat monitorohen brenda afatit kohor.
	5.2	Monitorimi dhe analiza e Projekt buxheteve ekonomike të SHA-ve dhe planeve ekonomike financiare të ndërmarrjeve me vetëfinancim për vitin 2020.		% e perputhjes me objektivat e realizuar nga ato të planifikuar.
	5.3	Monitorimi periodik i kontratave të objekteve të dhëna me qira nga SHA-të dhe ndërmarrjet me vetëfinancim dhe i procesit të qiradhënies		% e ndërmarrjeve dhe SHA-ve të monitoruara
	5.4	Hartimi i Bilancit të konsoliduar të institucioneve të varësisë, ndërmarrjeve dhe shoqërive aksionere të Bashkisë Tiranë		% e ndërmarrjeve që kërkojnë saktësim të të dhënave të bilancit,
Mirëadministrim i financimeve e mbështetjes donatore dhe zhvillimin e praktikave donatore për realizimin e projekteve	6.1	Projekti "Adopto një cerdhe" dhe "Adopto një kopsht"	Drejtoria e Koordinimit me Donatorët	Numri i raportet të perfunduara
	6.2	Gjelberim, mobilim urban, mbjelljet e reja në Tiranë, rehabilitimi i mjediseve publike		Numri i projekteve dhe kontratave të nënshkruara
	6.3	Projektet e investimit në infrastrukture, shkolla, rrugë, sinjalistike, etj.		Numri i projekteve Numri i Marreveshjeve të bashkepunimit.
	6.4	Dhurim automjete, pajisje, kompjutera etj		Numri i granteve/financimeve
	6.5	Projekte kulturore+ sociale + ndihma humanitare		
	6.6	Marreveshje bashkepunimi, Programe Financimi, Grante, etj		

Zbatimin e rregullave dhe ligjeve te menaxhimit financiar dhe kontrollit, ne procesin e menaxhimit te fondeve buxhetore , mbajtjen e kontabilitetit te aktivitetit dhe hartimin e llogarisë vjetore ne nivelin e njësisë shpenzuese te Aparatit te Bashkise Tirane	7.1	Ekzekutimi i transaksioneve të ndryshme financiare dhe kontabilizimi i tyre;	Drejtoria e Finances	Nr I transaksioneve te kryera
	7.2	Rakordimi mujor me Degën e Thesarit për shpenzimet;		Realizimi I raportimit %
	7.3	Raportimi I detyrimeve te prapambetura per apartatin e Bashkise Tirane		Realizim I Raportimit %
	7.4	Përgatitja e bilancit vjetor		Realizimi me sukses
	7.5	Bashkëpunon dhe bashkërendon punën me drejtoret e drejtorive të tjera në bashki, për problemet që kanë të bëjnë me fushën e veprimtarisë së drejtorisë, për menaxhimin e riskut, me strukturat përkatëse në bashki dhe institucionet e varësisë.		Numri I bashkepunimeve me strukturat e tjera
Planifikimi I te ardhurave dhe monitorimi i treguesve financiarë për mbrojtjen e interesave të Bashkise së Tiranës	8.1	Paraqitja per miratim e te ardhurave per PBA dhe per vitin buxhetor	Drejtoria e Monitorimit te Taksave dhe Tarifave Vendore	PBA e hartuar dhe miratuar
	8.2	Ndjekja e realizimit te te ardhurave		Realizimi %
	8.3	Angazhimi ne perpilimin e Vendimeve te Keshillit Bashkiak ne lidhje me ndryshimet per taksat dhe tarifat vendore		VKB te miratuara dhe publikuara
	8.4	Raportimi per realizimin e te ardhurave		Realizimi %

PLANI I DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË OBJEKTEVE NË BASHKËPRONËSI, ADMINISTRIMIT TË NJËSIVE ADMINISTRATIVE DHE EMERGJENCEVE CIVILE (2022)

<p>Misioni:</p>	<p>DPOBANJAEC është përgjegjese për administrimin e çdo çështje që lidhet me sigurimin e ofrimit të shërbimeve në fushën e bashkëpronësisë dhe koordinimit me 24 Njësitë Administrative dhe 3 Lagjeve si dhe për mirëadministrimin e çdo çështje që lidhet me menaxhimin e rasteve të emergjencave civile duke marrë masat e duhura parandaluese dhe masa konkrete për minimizimin e pasojave.</p>			
OBJEKTIVAT	PROJEKTE / AKTIVITETE		DREJTORIA PËRGJEGJËSE	INDIKATORËT
<p>Hartimin e politikave për implementimin e projektit për Administrimin e Bashkëpronësisë.</p>	1.1	Regjistrimi dhe formalizimi i strukturave të Kryesive	<p>Drejtoria e Objekteve në Bashkepronësi</p>	Numri i kryesive të regjistruara
	1.2	Regjistrimi dhe formalizimi i Administratorëve		Numri i administratorëve të formalizuar
	1.3	Regjistrimi dhe formalizimi i kontratave mes kryesive dhe administratorëve		Numri i kontratave
	1.4	Inspektimi i veprimtarisë së administratorëve		Numri i Inspektimeve
	1.5	Digjitalizimi ne sistemin Online për të gjitha objektet e banimit		Sistem online funksional
	1.6	Përcaktimi i standardeve minimale për ruajtjen e higjienës, shëndetit publik, mbrojtjen kundër zjarrit si dhe mirëmbajtjen fizike të mjediseve që janë pjesë e aktit të bashkëpronësisë		Rregullore e hartuar dhe e miratuar
<p>Programi "Fondi i Komuniteteve"</p>	2.1	<p>Bashkëpunim me të gjitha kryesitë dhe administratorët e certifikuar për të nxitur aplikime të reja dhe ndjekja e te gjitha hapave per zbatimin e projekteve te shpallura fituese me çdo drejtori përfshirëse si Drejtoria e Punëve Publike, Drejtoria Juridike, Drejtoria e Financës si dhe Komisioneve të Monitorimit, të ngritur me Urdhër Kryetari, duke vënë në dispozicion të gjithë dokumentacionin për finalizimin me sukses të këtij procesi.</p>		<p>Numri i projekteve të miratuara</p>

Konsolidimi i strukturave komunitare në qytet dhe në fshat	3.1	Bashkëpunimi me D.P Teknologjisë së Informacionit Inovacionit dhe të Dhënave për krijimin e platformës së strukturave komunitare	Drejtoria e Administrimit të NJA-ve dhe AMTP-ve	Database funksional
	3.2	Organizimi i ëorkshop-eve për njohjen e detyrave funksionale të strukturave komunitare		Numri i trajnimeve ëorkshopeve
	3.3	Përgatitja në formë broshure e akteve ligjore e nënligjore për strukturat komunitare		Numri i broshurave
Përgatitja për zgjedhjet për organet e pushtetit vendor të vitit 2023	4.1	Njohja e NJA-ve me Dekretin e Presidentit për caktimin e datës së zgjedhjeve		Numri i akteve
	4.2	Njohja me udhëzimeve të KQZ-së në zbatim të kërkesave të Kodit Zgjedhor për zgjedhjet vendore		Realizimi %
	4.3	Përditësimi i listës së zgjedhësve dhe i Formularëve TIP për Qendrat e Votimit		Realizimi%
Pjesëmarrja dhe përfaqësimi i Bashkisë Tiranë dhe Njësive në rang ndërinstytucional.	5.1	Njohja e plotë e organizimit të Bashkisë Tiranë dhe përfaqësim në mbrojtje të interesave dhe qëllimeve të Bashkisë Tiranë.		Realizimi%
Vazhdimi i plotësimit të databazës me VNM e ardhura në sistemin E-leje	6.1	Shqyrtimi i aplikimeve për VNM paraprake dhe të thelluara në sistemin E-leje dhe trajtimi i tyre brenda afateve të caktuara ligjore;		Numri i aplikimeve
Marrja e shkresave të ardhura pranë sektorit dhe në bazë të tyre kthimi i përgjigjes kërkuesit;	7.1	Mban korespondencën e të gjitha shkresave hyrëse dhe dalëse;		Database funksional

<p>Zhvillimi dhe përmirësimi në vazhdimësi i procedurave të punës, për të ofruar cilësi të lartë dhe përgjigje të shpejtë ndaj kërkesave të komunitetit, në bashkëpunim me Njësitë Administrative në varësi të Bashkisë së Tiranës, për realizimin e objektivave;</p>	<p>8.1</p>	<p>Marrja e informacionit të vazhdueshëm nga drejtori të ndryshme/njësitë administrative të përfshira në procesin e lejeve mjedisore;</p>		<p>Realizim %</p>
<p>Marrja e masave për parandalimin, parapergatitjen për përgjigjen ndaj situatave emergjente që mund të krijohen nga fatkqësi natyrore ose nga dora e njeriut, në territorin që administron Bashkia Tiranë.</p>	<p>9.1</p>	<p>Përgatitja, miratimi dhe përditësimi i Planit Vendor të Emergjencave.</p>		<p>Plan Vendor I miratuar</p>
	<p>9.2</p>	<p>Përditësimi i sistemit të lajmerimit të Bashkisë Tiranë, Njësitë Administrative, dhe institucioneve të varësisë</p>		<p>Sistem funksional</p>
	<p>9.3</p>	<p>Ngritja e strukturave të përhershme ose të përkohshme, grupet e verifikimit në terren të demeve në rastet emergjente.</p>		<p>Numri i strukturave të ngritura</p>
	<p>9.4</p>	<p>Evidentimi dhe përcaktimi i të gjitha zonave me rrezik në territorin që përfshin Bashkia Tiranë.</p>		<p>Vendosja e koordinatave në hartë</p>
	<p>9.5</p>	<p>Kapacitetet në burime njerëzore e logjistike dhe gjendjes aktuale por edhe mundësinë e shtimit të vendeve të përshtatshme për evakuimin e popullatës në rast emergjence.</p>		<p>Numri dhe vendodhja e ambjenteve në dispozicion dhe nr. i grupeve operative.</p>
<p>Marrja e masave konkrete me qëllim parandalimin e rrezikut që mund të shkaktohet nga fatkqësitë natyrore.</p>	<p>10.1</p>	<p>Kryerja e raporteve teknike dhe rinovimi i marrëveshjes me Institutin e Ndërtimit me qëllim përcaktimin e saktë të shkaqeve të dëmit</p>		<p>Numri i raporteve teknike</p>
	<p>10.2</p>	<p>Kryerja e studimeve gjeologjike nga Sherbimi Gjeologjik Shqiptar nëpërmjet AKMC</p>		<p>Numri i studimeve</p>
	<p>10.3</p>	<p>Kryerja e investimeve sipas buxhetit të përcaktuar për vitin 2020.</p>		<p>Realizimi me sukses</p>
	<p>10.4</p>	<p>Ndjekja e procedurave për akt ekspertizat për pallatet e demtuara nga tërmeti 26.11.2019 të kryera nga Instituti i Ndërtimit.</p>		<p>Numri i akt ekspertizave të kryera.</p>

	10.5	Ndjekja e procedurave per akt ekspertizat e thelluara per pallatet e demtuara nga termeti 26.11.2019 te kryera nga operatorët ekonomik.		Numri I aktekspertizave te thelluara.
Përmirësimi i kushteve të jetesës dhe rehabilitimi për të arritur aftësinë ripërtëritëse me qëllim zvogëlimin e riskut të fatkeqësive në të ardhmen.	11.1	Trajtimi me ndihmë financiare i banorëve të prekur nga fatkeqësi natyrore për mbulimin e dëmeve të shkaktuara.		Numri i dëmshpërblimeve.
	11.2	Takime dhe konsultime me specialistët e njësive administrative dhe grupe vullnetare.		Numri I takimeve
	11.3	Kryerja e manovrave stërvitore / simulime.		Numri I manovrave / simulimeve
	11.4	Trajnime profesionale me qëllim rritjen e performancës dhe efektivitetit në realizimin me sukses të punës dhe objektivave.		Numri I trajnimeve Numri I te trajnuarve
Procedurat per demelimin e objekteve (pallate)	12.1	Ndjekja e kontratave per vijimin e procedurave per demelimin e objekteve pallate te demtuara nga termeti I datës 26.11.2019.		Numri I kontratave
	12.2	Monitorimi I procesit te demolimit per secilin objekt dhe ndjekja hap pas hapi per plotesimin e dokumentacionit dhe mbarevejtjen e procedures.		Numri i pallateve te demoluara

PLANI I DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN DHE JASHTË 2022

Misioni:	DPMPJ është ë përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve publike ndaj qytetarit, administrimin e komunikimit me qytetarin përmes kanaleve online të komunikimit, për zbatimin e politikës së jashtme të institucionit dhe zhvillimin dhe fuqizimin e lidhjeve me shtete/qytete/bashki të huaja dhe organizata ndërkombëtaresi dhe është përgjegjës për protokollin dhe ceremonialin zyrtar.			
OBJEKTIVAT		PROJEKTE / AKTIVITETE	DREJTORIA PËRGJEGJËSE	INDIKATORËT
Zhvillimi dhe fuqizimi I lidhjeve me shtete/qytete/bashki të huaja dhe organizata ndërkombëtare, si dhe shprehja e interesave të institucionit në marrëdhëniet ndërkombëtare me shtete/bashki dhe organizata të huaja	1.1	Koordinimi i pjesëmarrjeve të Kryetarit/Nënkryetarëve në evenimente të organizuara nga partnerë/organizata/rrjete qytetesh të vogla	Drejtoria e Marredhenieve me Jashte	Nr. I evenimenteve të koordinuara
	1.2	Koordinimi i takimeve të Kryetarit/Nënkryetarëve me përfaqësues të misioneve diplomatike në Shqipëri, si dhe ndjekja e mëtejshme e bisedimeve mes palëve		Nr. I takimeve të koordinuara
	1.3	Ndërmjetësimi i komunikimit me partnerë të huaj, si dhe ndjekja e hapave për cdo bashkëpunim të mundshëm		Nr. I ndërmjetësimeve
	1.4	Koordinimi i vizitave/takimeve të Kryetarit me homologë të huaj jashtë vendit		Nr. I vizitave të zhvilluara
	1.5	Koordinimi I programit të vizitave të bashkëpunëtorëve të huaj në Tiranë		Nr. I vizitave
	1.6	Ndërmjetësimi I përfshirjes së qyteteve të huaja në programin e aktiviteteve Tirana EYC 2022		Nr. I qyteteve pjesëmarrëse
Standardizimi I mënyrës së ofrimit të shërbimeve në sportel, sipas modeleve kombëtare të hartuara dhe përshtatur nga autoriteti përgjegjës dhe të rekomanduara për zbatim për Bashkinë Tiranë si njësi e vetëqeverisjes vendore	2.1	Riinxhinierimi I proceseve të punës dhe shfrytëzimi I zgjidhjeve që ofron teknologjia: a) Shtimi I shërbimeve live në OSSH. Pilotimi I shërbimeve live në disa njësi administrative; b) Publikimi I njoftimeve publike elektronike	Drejtoria e Komunikimit me Qytetarët	Nr. I shërbimeve live të shtuara/pilotuara % e njoftimeve publike elektronike
	2.2	Hartimi dhe realizimi I kartelave informuese për cdo shërbim që ofrohet në Bashkinë Qendër, të pajisura me të gjithë elementët e informimit konform kuadrit ligjor përkatës		Nr. I kartelave informuese
	2.3	Zhvillimi I kapaciteteve të stafit që ofron shërbim për qytetari përmes sesioneve trajnuese		Nr. I trajnimeve

	2.4	Rritja e eficences së komunikimit online me qytetarët, si dhe nr të gjelbër përmes përmirësimeve teknologjike		Numri I Instalimeve teknologjike/aplikacione të përditësuar
Rikonceptimi I faqes zyrtare të BT-së, sa u takon shërbimeve, raportimeve, informacionit online dhe opinioneve qytetare	3.1	Ndërtimi I një strukture të re të vendosjes së informacionit lidhur me shërbimet publike në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë Tiranë		Nr. I rubrikave të rikonceptuara/të reja
	3.2	Krijimi I BT Survey - Administrimi I anketimeve online		Nr. I anketimeve të realizuara online
	3.3	Publikimi periodik I raporteve dhe statistikave		Nr. I raporteve dhe statistikave të publikuara
Unifikimi I mbledhjes së të dhënave për shërbimet ndaj qytetarit nga ana e Njësive Administrative dhe raportim periodik I tyre pranë DKQ	4.1	Krijimi I një modeli të unifikuar të raportimit të të dhënave për Njësitë Administrative		Nr. I Njësive Administrative që përdorin modelin e unifikuar
	4.2	Hartimi I raporteve periodike për Njësitë Administrative		Nr. I raporteve periodike për Njësitë Administrative
Realizimi dhe organizimi I pritjeve, aktiviteteve, ditëve festive sipas protokollit ceremonial	5.1	Koordinimi dhe përgatitja e veprimtarive protokollare dhe ceremoniale të vizitave të homologëve të Kryetarit të Bashkisë	Drejtoria e Protokollit dhe Ceremonialit Zyrtar	Nr. I aktiviteteve të realizuara
	5.2	Koordinimi I zbatimit të programit të vizitave të delegacioneve të huaja të nivelit të lartë, të cilat programohen nga Protokollit I Shtetit ose kërkojnë të vizitojnë Kryetarin e Bashkisë Tiranë		Nr. I aktiviteteve të realizuara
	5.3	Asistencë protokollare për veprime të paparashikuara në mbështetje të axhendës së Kryetarit		Nr. I aktiviteteve të realizuara
	5.4	Asistencë në aktivitete/ceremoni të TEYC 2022		Nr. I aktiviteteve të realizuara

PLANI I DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PUNËVE PUBLIKE 2022

Misioni:	DPPP është përgjegjëse për mirëadministrimin e çdo çështje që lidhet me identifikimin, analizimin dhe hartimin e politikave të punëve publike për shërbimet e infrastrukturës, menaxhimit dhe trajtimit të mbetjeve, investimeve, transportit dhe shërbimeve të ofruara nga Bashkia Tiranë			
OBJEKTIVAT	PROJEKTE / AKTIVITETE		DREJTORIA PËRGJEGJËSE	INDIKATORËT
Të vlerësojë prioritetet bazuar në strategjinë sektoriale për zhvillimin e infrastrukturës urbane dhe objekteve arsimore	1.1	Vlerësimi i prioriteteve sipas kërkesave të bëra në vazhdimësi	Drejtoria e Planifikimit të Punëve Publike	Realizimi ne %
Të marrë pjesë dhe të paraqesë propozime gjatë hartimit PBA	2.1	Gjatë gjithë vitit në vazhdimësi për programin e Infrastrukturës së Transportit, Shërbimeve Publike/Arsimit Parauniversitar dhe Edukimit, Kujdesit Social.		Realizimi me sukses
Të përcaktojë koston e plotë për objektet e Infrastrukturës Urbane/Objekteve Arsimore gjatë hartimit të PBA dhe rishikimit të saj	3.1	Gjatë gjithë vitit në vazhdimësi		Dërgimi I tyre me shkresë/e-mail DPMF të kostove 7 dite para mbledhjes së KB.
Të krijojë një database për të gjitha investimet që janë realizuar apo janë në proces	4.1	Marje informacioni nga Sektori i Kontrollit të Projekteve pranë Drejtorisë sonë si dhe Drejtorisë së Prokurimeve, për investimet e realizuara apo që janë në proces		Database funksional
Të kthejë përgjigje ligjore dhe teknike për problemet specifike që mbulon Drejtoria	5.1	Trajtimi i shkresave dhe zbatimi i afatit ligjor për kthimin e përgjigjeve qytetarëve apo institucioneve.		Realizimi me sukses
Zbatimi i Buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2022-2024	6.1	Inspektimi në terren për objektet e parashikuara për 2022		Numri inspektimeve
	6.2	Hartimi i Detyrave të projektimit		Numri I detyrave te projektimit
	6.3	Pjesmarrje në Këshill Teknik për shqyrtim dhe miratim të DP-ve		Realizimi me sukses
	6.4	Dërgimi i DP-ve për prokurim pranë Drejtorisë së Prokurimeve	Realizim me sukses	

	6.5	Kontrolli i projekt-ideve paraprake	Miratimi në Këshill Teknik dhe përzgjedhja e variantit
	6.6	Pjesëmarrje në Këshill Teknik për shqyrtim dhe miratim të projekt-ideve paraprake	Realizimi me sukses
	6.7	Kontrolli i projekt-ideve përfundimtare	Ndjekja e kontrates së lidhur
	6.8	Dërgimi për Oponencë i projektit (kur parashikohet)	Ndjekja e kontrates së lidhur
	6.9	Pjesëmarrje në Këshill Teknik për shqyrtim dhe miratim të projekt/zbatimit	Realizimi I kontrates së lidhur
	6.10	Dërgim i projekt/zbatimit për prokurim	Zbatim I regjistrit të prokurimeve
Pjesëmarrje në Procedurat e Prokurimit	7.1	Pjesëmarrje në njesitë e prokurimit (Hartimi I DSt-ve)	Zbatimi I regjistrit të prokurimeve
	7.2	Pjesëmarrje në KVO	Zbatimi I regjistrit të prokurimeve
Zgjidhje e problematikave të ndryshme	8.1	Kthim përgjigje shkresave të ardhura nga qytetarët/institucione	% e shkresave të trajtuar
Detyra administrative/funksionale	9.1	Rishikim projektsh të ndryshme të inicuar në vitin 2020-2021	Miratimi në Këshill Teknik
	9.2	Dërgim për prokurim projektsh të ndryshme të inicuar dhe hartuara në vitet paraardhese, të pasqyruara në buxhetin e vitit 2021	Numri I procedurave të realizuara
	9.3	Kontrolli, dhe ndjekja e procedurave për miratimin e projekteve të hartuara nga donatorët, Bashkia, dhe/ose Institucione në varesi	Miratimi në Këshill Teknik
	9.4	Kontroll projektsh të cilat janë prokuruar në fund-viti 2021	Miratimi në Këshill Teknik
	9.5	Krijimi I database për investimet e infrastruktures Publike	Database funksional
Organizimi i Mbledhjeve të Këshillit Teknik	10.1	Përgatitja e materialeve për Këshill Teknik dhe organizimi i tij	Realizimi me sukses

Monitorimi i puneve publike	11.1	Monitorimi i shërbimeve të ofruara (DPPGJ) dhe (DPRRNP) të realizuara në Njësitë Administrative Nr. 1- 24 dhe Lagjet 12-14, të Qytetit të Tiranës	Drejtoria e Monitorimit te Puneve Publike	Numri i objekteve të monitoruara
	11.2	Monitorimi i Shërbimeve Funerale në Varrezat Tufinë dhe Sharrë dhe NjA		Numri i shërbimeve të monitoruara
	11.3	Monitorimi i mirëmbajtjes së banesave sociale		Numri i banesave sociale të mirëmbajtura
	11.4	Monitorimi i mirëmbajtjes së banesave sociale 1(një) katëshe në Shkozë dhe Lanabregas		Numri i banesave sociale
	11.5	Monitorim operativ dhe vlerësim, çdo muaj i punimeve te realizuara nga DPOP dhe DPÇK		Numri i objekteve të monitoruara
	11.6	Rritja e cilësisë së shërbimeve të ofruara nga Qendrat Sociale;		Numri i shërbimeve të monitoruara në QS
	11.7	Rritja e cilësisë së shërbimeve të ofruara nga Qendrat Kulturore;		Numri i shërbimeve të monitoruara në QK
	11.8	Rritja e cilësisë së shërbimeve të ofruara nga DKShM		Numri i shërbimeve të monitoruara
Menaxhimi dhe mireadministrimi I procedurave dhe projekteve qe lidhen me rrjetet e shtrira ne territorin e BT-se	12.1	Ndjekja në vazhdimësi i punës për kalimin e kabllove nga sistemi ajror në tubacione nëntokësore të linjave rezerve. Dhënie e informacioni AKEP, mbi linjat rezerve investuar nga Bashkia.	Drejtoria e Rrjeteve	Nr. projekteve
	12.2	Stimulimi i praktikave të efijencës së energjisë për investimet publike, si në infrastrukturën rrugore ashtu edhe në institucionet e edukimit, shëndetësisë, administratës, në territorin që administrohet prej Bashkisë Tiranë.		Krijimi i nje baze te dhenash funksionale mbi konsumin e energjise ne ndertesat ne pronesi dhe administrim te Bashkise. (SEMP)
	12.3	Hartimi i raportit për nevojat per investime për Administrimin e Ujrave;		Raport i perfunduar
